



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 19 Prot.

Tiranë, më 8/10 2010

**Lënda:** Rekomandim për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, "I.S.K.SH"

**REKOMANDIM**

Nr. 19, datë 08/10/2010

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacioneve të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesve, Qendrave Shëndetësore nr.1 dhe nr.2 Tiranë,

**KONSTATOVA**

Më datë 22/09/20 dhe 23/09/2010 nga grupi i inspektimit të zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesve, Qendrat Shëndetësore nr.1 dhe nr.2 Tiranë, me cilësinë si kontrollues që mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tyre, me objekt:

- A njihet ligji nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ç`masa janë marrë për implementimin e tij.
- C`farë të dhënash përpunoni (të dhëna personale, sensitive, biometrike etj.).
- Për këto të dhëna a zbatohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- C`masa merren për sigurinë e të dhënave personale të pacientëve. Ku mbahen të dhënat ( të dhëna identifikuese, rezultate analizash etj) dhe koha e mbajtjes së tyre.
- A përpunohen e transmetohen të dhëna për qëllime statistikore, gazetarie e literature. Nëse zbatohen kriteret e parashikuara në nenet 10 e 11 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- Nëse kanë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme.

- Nëse ka instalime me kamera, si përdoren dhe a janë në dijeni subjektet e të dhënave për përdorimin e tyre.
- A njihen të drejtat e subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe si zbatohen këto të drejta..
- Nëse e njohin detyrimin për të njoftuar të dhënat personale që përpunojnë, në ç'shikullë dhe si veprohet.
- Nëse dhe në c'masë zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.

Komisioneri "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" pasi shqyrtoi procesverbalet e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

- 1) Kontrolluesi, Qendra Shëndetësore Nr.1 Tiranë, nuk ka përfunduar plotësisht detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
  - Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.*
- 2) Kontrolluesit, Qendrat Shëndetësore nr.1 dhe nr.2 Tiranë, nuk kanë marrë masa të përshtatshme sigurie lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale që mbartin përgjigjet e analizave që kryhen në laboratorin e tij (si: emri, mbiemri, tregues të analizave etj, të cilat janë të dhëna sensitive që kanë të bëjnë me shëndetin sipas nenit 7 të Ligjit nr.9887, dt.10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*") për pacientet në procesin e shpërndarjes, duke mos i mbyllur përgjigjet e analizave në zarfe të veçanta për secilin pacient.
  - Këto veprime konsiderohen shkelje të kërkesave të nenit 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", "*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*".
- 3) Kontrolluesit, Qendrat Shëndetësore nr.1 dhe nr.2 Tiranë mbajnë dokumente të tilla si; regjistri i vizitave të mjekut, blloku i vizitave, rekomandimet mjekësore, rekomandimet për analiza mjekësore, kartelat mjekësore të pacientëve të vdekur etj,



për një kohë më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar.

- Në këtë rast nuk janë respektuar kërkesat e nenit 5, pika "1/d" i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", "*Në mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej*".
  - Gjithashtu nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 27/2 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", "*Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshme për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.*"
- 4) Këta kontrollues nuk kanë rregullore të veçantë apo rregulla lidhur me sigurinë dhe konfidencialitetin për të dhënat personale.
- Moskryerja e kësaj detyre ligjore përbën shkelje të kërkesave të nenit 27/2/c të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", "*Kontrolluesi, udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave*".

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

1. Të merren masat e nevojshme që brenda datës 31.10.2010 Qendra Shëndetësore nr.1 Tiranë, të plotësojë formularin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke respektuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".
2. Të zbatohen me rigorozitet kërkesat e nenit 27 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" duke vendosur mënyra që duhet të zbatojnë Qendrat shëndetësore, lidhur me zarfimin e fletëve me rezultatet e analizave mjekësore në laborator.
3. Të hartohet rregullore e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, duke respektuar kërkesat e neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", duke përcaktuar afate të qarta të ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit që disponon të dhëna personale.

4. Të zbatohen me rigorozitet kërkesat e nenit 5, pika 1 germa "b" të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Udhëzimi nr.5, datë 26.05.2010 mbi "Rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor."

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej tre muajsh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

